



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 105 Prot.

Tiranë, më 30.01.2024

URDHËR

Nr. 22, Datë 30.01.2024

Për kryerjen e inspektimit të thelluar, në lidhje me zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil, në zhvillimin e procedurave gjatë aplikimit të institutit të disiplinës, në institucionin e Institutit të Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit

Në mbështetje dhe në zbatim të nenit 11, pika 1 dhe nenit 14, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, ndryshuar, si dhe neneve 2 dhe 14 germa a), neneve 16 dhe 19, pika 1 dhe 21 të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, të miratuar me Vendimin nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i ndryshuar, nisur nga problematika e përcjellë nëpërmjet disa informacioneve pranë Komisionerit,

URDHËROJ:

1. Nisjen e inspektimit për verifikimin e zbatimit të ligjit në administrimin e shërbimit civil, gjatë realizimit të procedurave disiplinore, në institucionin e Institutit të Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit.
2. Inspektimi do të përfshijë sipas objektit, veprimet administrative të kryera nga eprori direkt, Komisioni i Disiplinës dhe subjektet/mekanizmat e tjera të ngarkuara me detyra specifike gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil.
3. Procesi i inspektimit do të kryhet në institucion nga data **05.02.2024**, me paraqitjen e grupit të punës pranë institucionit të Institutit të Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, ku do të vijohet me procesin e grumbullimit të të dhënave. Vizita në institucion do të zgjasë deri në datë **08.02.2024**.
4. Për çdo parregullsi të konstatuar do të mbahet akt konstatimi dhe do të merret kopja e dokumentacionit përkatës, e vërtetuar nga sekretaria e institucionit.
5. Grupi i inspektimit do të ketë përbërjen si më poshtë:

Luiseda Zhapa

Drejtor i Inspektimit dhe Hetimit Administrativ
(Drejtues grupi)

Françeska Doksani Inspektore
(Anëtar)

Dorela Halilaj Inspektore
(Anëtar)

6. Inspektimi do të orientohet drejt verifikimit të situatës së administrimit të shërbimit civil, të një kategorie veprimesh administrative në këtë institucion, në lidhje me procedurën e ndjekur në zbatimin e institutit të disiplinës në shërbimin civil, sipas këtyre drejtimeve:
 - a. Verifikimi i statusit të punonjësit në procedim disiplinor.
 - b. Procedura e ndjekur nga eprori direkt në lidhje me klasifikimin e shkeljeve sipas pikës 1, të nenit 57, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunës civil”*, i ndryshuar.
 - c. Respektimi i rregullave të hollësishme të procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen dhe vendimmarrjen në komisionin disiplinor, në përputhje me kërkesat e Vendimit nr. 115, datë 05.03.2014, *“Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil”*, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr. 01, datë 02.04.2023, *“Për elementët kryesorë proceduralë dhe materialë të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”*, të DAP.
 - d. Verifikimi i akteve të nxjerra nga Komisioni i Disiplinës dhe eprori direkt, gjatë zhvillimit të procedurës disiplinore.
 - e. Probleme të ndryshme që i kanë lindur njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore gjatë punës për zbatimin e nenit 57 deri 60, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar.
7. Për të përfunduar këtë proces, grupit të inspektimit duhet t’i vihen në dispozicion aktet administrative që dokumentojnë procesin e ecurisë disiplinore, të evidentuara si më poshtë:
 - Urdhrin për krijimin e Komisionit të Përhershëm të Disiplinës, sipas kërkesave të nenit 59, pika 3, e ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar;
 - Kërkesën për fillimin e ecurisë disiplinore, duke përfshirë aktet administrative, të cilat kanë shërbyer si bazë për fillimin e kësaj procedure;
 - Urdhrin për ngritjen e Komisionit Disiplinor, ku të specifikohet përbërja nominale e tij, sipas pozicioneve ku ushtrojnë detyrën anëtarët e tij, deklaratat e konfliktit të interesit si dhe çdo akt administrativ tjetër që materializon zëvendësimin/ndryshimin e anëtarëve të këtij organi administrativ;

- Aktet e emërimit të anëtarëve të Komisionit Disiplinor, për pozicionet ku ata aktualisht ushtrojnë detyrën, si dhe aktet e deklarimit të statusit të punësimit si nëpunës civil;
 - Procesverbalet dhe provat shkresore të administruara gjatë seancave dëgjimore të shqyrtimit të shkeljes disiplinore ndaj nëpunëses në fjalë;
 - Aktet administrative që materializojnë veprimtarinë dhe vendimmarrjen e Komisionit Disiplinor.
8. Materiale të tjera të cilat do të konsiderohen të domosdoshme për verifikimin e situatës së shërbimit civil në këtë institucion dhe do të kërkohen gjatë procesit të inspektimit.
9. Urdhëri hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha